



Republika e Kosovës
Republika Kosova – Republic of Kosovo



Komuna e Prishtinës
Opština Priština – Municipality of Prishtina

Në bazë të dispozitave të nenit 12, paragrafi 12.2, pika d e Ligjit nr. 03/L – 040, për vetëqeverisje lokale (“Gazeta zyrtare e Republikës së Kosovës”, nr. 28/2008), dispozitave të nenit 8 të Ligjit nr. 04/L-010, për bashkëpunim ndërkomunal, nenit 5 të Rregullores nr. 09/2013, për nxitjen e bashkëpunimit ndërkomunal, dhe dispozitave të nenit 34, paragrafi 34.1, pika d e Statutit të Komunës së Prishtinës, 01. nr. 110 – 391, të dt. 25.02.2010, Kuvendi i Kryeqytetit, në mbledhjen e mbajtur më 9.10.2023, miratoi këtë

V E N D I M

I.

MIRATOHET Vendimi për marrëveshjet e bashkëpunimit ndërmjet Kryeqytetit të Republikës së Kosovës, Prishtinës, dhe Komunës së Obiliqit.

II.

Marrëveshja e bashkëpunimit ndërmjet Komunës së Obiliqit dhe Kryeqytetit të Republikës së Kosovës, Prishtinës, është bërë për realizimin e projektit të ngrohjes diellore “Solar4Kosovo” dhe realizimin e projekteve që dalin nga Marrëveshja për realizimin e projektit të ngrohjes diellore “Solar4Kosovo”.

III.

Për realizimin e këtyre marrëveshjeve do të kujdeset Kryetari i Kryeqytetit.

IV.

Ky vendim hyn në fuqi 15 (pesëmbëdhjetë) ditë pas regjistrimit në Zyrën e protokollit të Ministrisë së Administrimit të Pushtetit Lokal, si dhe 7 (shtatë) ditë pas publikimit në gjuhët zyrtare në ueb-faqen e Komunës.

KUVENDI I KRYEQYTETIT
01-024/01-204088/23, më 10.10.2023

KRYESUESI I KUVENDIT

Pëllumb Bajcinovci

